



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR.....	3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E BILANCIT TË FONDEVE	7
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË.....	9
1. Hyrje.....	10
2. Politikat e kontabilitetit	11
3. Pasurit qarkulluese.....	12
4. Paraja dhe ekuivalentët e saj.....	12
5. Llogaritë e Arkëtueshme	12
6. Llogaritë e Pagueshme.....	13
7. Të pagueshmet tjera	13
8. Të hyrat	14
9. Shpenzimet e Pagave	14
10. Shpenzime operative.....	15
11. Ngjarjet pasuese	16



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Menaxhmentit të Federata e Basketbollit të Kosovës

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Federata e Basketbollit të Kosovës, që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2022, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Federata e Basketbollit të Kosovës më 31 Dhjetor 2022, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Ligjet aktuale në fuqi.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe personave që janë të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me ligjet aktuale në fuqi dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Organizatës.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Armend Osaj – Auditor Ligjor
ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtinë, Kosovë
10 Mars, 2023



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS - FBK
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
 Me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021
 Të gjitha shumat në Euro

Me 31 dhjetor		<u>2022</u>	<u>2021</u>
Asetet	<i>Shënimet</i>		
Asetet jo-qarkulluese			
Pajisjet dhe makinat	3	32,485	-
Total asetet jo-qarkulluese		<u>32,485</u>	<u>-</u>
Asetet qarkulluese			
Paraja	4	8,949	58,472
Llogarit e arketueshme	5	182,565	152,621
Parapagimet		1,491	1,482
Total asetet qarkulluese		<u>193,005</u>	<u>212,575</u>
TOTAL ASETET		<u>225,490</u>	<u>212,575</u>
Detyrimet dhe Ekuiteit			
Detyrimet afatshkurta			
Llogarit e pagushme	6	185,300	177,706
Të pagueshmet tjera	7	86,204	43,441
Total i detyrimeve afatshkurta		<u>271,504</u>	<u>221,147</u>
Ekuiteti			
Saldoja e bartur		(8,572)	(103,302)
Net (deficiti)/suficiti I vitit		(37,441)	94,729
Total i ekuitetit		<u>(46,013)</u>	<u>(8,572)</u>
TOTALI I DETYRIMEVE DHE BILANCI I FONDIT		<u>225,490</u>	<u>212,575</u>

Aprovuar nga:

Arben Fetahu, Kryetar



Shënimet e bashkëngjitura në faqet 7 deri 13 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS - FBK
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021
Të gjitha shumat në Euro

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor		2022	2021
	<i>Shënimet</i>		
Të hyrat			
Të hyrat	8	1,338,618	1,232,607
TOTALI I TË HYRAVE		1,338,204	1,232,607
Shpenzimet			
Shpenzimet për Paga të Stafit	9	(148,060)	(105,064)
Shpenzimet Operative	10	(1,015,359)	(1,032,814)
TOTALI I SHPENZIMEVE		(1,375,646)	(1,137,878)
TEPRICA(HUMBJA)		(37,441)	94,729

Shënimet e bashkëngjitura në faqet 7 deri 13 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS - FBK**PASQYRA E BILANCIT TË FONDEVE**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021

Të gjitha shumat në Euro

	Bilanci i fondeve	Gjithsej
Më 31 dhjetor 2020	(106,602)	(106,602)
Fitimi / (humbja) i/e vitit	94,729	94,729
Korigjimi	3,300	3,300
Më 31 dhjetor 2021	(8,572)	(8,572)
Fitimi / (humbja) i/e vitit	(37,441)	(37,441)
Më 31 dhjetor 2022	(46,013)	(46,013)

Shënimet e bashkëngjitura në faqet 7 deri 13 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS - FBK**PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021

Të gjitha shumat në Euro

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	Shënimi	2022	2021
I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Teprica (humbja)	PAGJ	(37,441)	94,729
<i>Korigjuar për transaksionet jo monetare:</i>			
Shpenzimet e zhvlersimit		3,609	
Korigjimi nga vitet e kaluara			3,300
		(33,832)	98,029
Lëvizjet në kapitalin qarkullues			
(Rritja)/Zvogëlimi në të arkëtueshme	5	(29,944)	5,599
(Rritja)/Zvogëlimi në avanset e dhëna		(9)	2,330
Rritja/(Zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme dhe të tjera	6	7,594	(92,773)
Rritja/(Zvogëlimi) në tatime dhe paga të pagueshme	7	42,762	28,969
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative (I)		(13,429)	42,154
II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese	3	(36,094)	
Blerja / shitja e pasurive joqarkulluese			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese (II)		(36,094)	-
III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Rritja/(Zvogëlimi) huamarrjeve			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese (III)			-
IV. Rritja neto në para dhe ekuivalente (I + II + III)		(49,523)	42,154
V. Paraja në fillim të vitit/periudhës	4	58,472	16,318
VI. Paraja në fillim të vitit/periudhës (IV + V)	4	8,949	58,472

Shënimet e bashkëngjitura në faqet 7 deri 13 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021

Të gjitha shumat në Euro

1. Hyrje

Federata e Basketbollit e Kosovës është asociacion vullnetar i pavarur i klubeve dhe shoqatave të themeluara nga qytetarët, me qëllim të interesave të veçanta dhe të përbashkëta në lëmin e sportit të basketbollit.

Federata e Basketbollit e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Federata) është institucioni më i lartë i sportit të basketbollit në Kosovë për meshkuj dhe femra, që për veprimtari themelore e ka sportin e basketbollit, e organizuar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit për Sport e Kosovës.

Federata është subjekt juridik dhe vepron në pajtim me Statutin, Statutin dhe Rregulloret e FIBA-s, Ligjin për Sportin e Kosovës dhe Ligjin mbi organizatat jo fitimprurëse.

Federata, si organizatë jo fitimprurëse është e regjistruar në organin përgjegjës dhe e licencuar në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Kosovës (Departamenti i Sportit).

Qëllimet e Federatës janë:

- Masovizimi, zhvillimi cilësor dhe organizimi i basketbollit në Kosovë.
- Sigurimi dhe realizimi i të gjitha kushteve për veprimtarinë e seleksioneve të Federatës.
- Organizimi dhe avancimi profesional i lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve dhe vëzhguesve të basketbollit.
- Ndihma organizatave të tjera në promovimin e basketbollit në të gjitha fushëveprimet e sportit të basketbollit, në përputhje me aktet normative.
- Përcaktimi i sistemit të garave për të gjitha kategoritë në nivel të Federatës.
- Pjesëmarrja në manifestime dhe gara ndërkombëtare.
- Mbështetja e zhvillimit të basketbollit në vise të pazhvilluara të Kosovës.
- Organizimi i të gjitha garave në nivel të Kosovës, siç janë: Ligat, Kupa dhe turnetë.
- Organizimi i aktiviteteve profesionale vendore dhe ndërkombëtare.
- Organizimi i kampeve, seminareve, publikimeve profesionale etj.
- Sigurimi i bazës materiale për sportin e basketbollit nëpërmjet marketingut, aktiviteteve ekonomike me qëllim të përmbushjes të kërkesave për veprimtarinë e Federatës
- Përcaktimi i parimeve themelore mbi definimin e statusit të gjithë subjekteve në kuadër të Federatës.
- Pjesëmarrja në punën e KOK-ut dhe asociacioneve të tjera sportive.
- Veprimi kundër përdorimit të dopingut, në përputhje me vendimet e KOK-ut dhe FIBA-s.
- Pjesëmarrja në punën e organizatave të tjera sportive ndërkombëtare, të cilat janë të lidhura me sportin e basketbollit.

Anëtarët e Federatës janë: Klubet e basketbollit (publik edhe private), Shoqata e trajnerëve, Shoqata e gjyqtarëve (organizata profesionale të Federatës), dhe të gjitha klubet dhe shoqatat e tjera të cilat pranohen dhe licencohen në Federatë.

Çdo anëtar i Federatës duhet ta paguajë anëtarësinë vjetore, të cilën e cakton Kuvendi

Organet e Federatës janë:

- Kuvendi
- Bordi
- Kryetari
- Këshilli Mbikëqyrës

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021

Të gjitha shumat në Euro

2. Politikat e kontabilitetit

Në vijim janë politikat themelore të kontabilitetit të adaptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

2.1 Bazat e përgatitjes

Për qëllime të raportimit financiar për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022, FBK përdor bazën akruale të kontabilitetit sipas së cilës të hyrat dhe shpenzimet njihen në momentin kur ndodhin.

2.2 Transaksionet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë të shndërruara në vlerën monetare raportuese duke përdorur shkallën aktuale të këmbimit të transaksionit. Fitimi dhe humbja si rezultat i transaksioneve nga shëndrrimi në normat e këmbimit të fund- vitit të mjeteve monetare dhe detyrimeve në valutat e huaja janë të njohura në pasqyrën e të ardhurave.

2.3 Prona, impiantet dhe paisjet

Prona, pajisjet dhe impiantet janë matur me kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë).

Zhvlerësimi ngarkohet në mënyrë që të ndahet kosto e pasurive minus vlera e tyre e mbetur përgjatë jetës së përdorimit të parashikuar, duke përdorur metodën lineare. Normat vjetore e cila është përdorur për zhvlerësimin e pajisjeve është 20%.

2.4 Asetet Financiare

Asetet Financiare klasifikohen në kategoritë e specifikuar vijuese: mjetet financiare në vlerën reale përmes fitimit apo humbjes, kreditë dhe të arkëtueshmet, mallrat e gatshmet për shitje. Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi e mjeteve financiare që janë përvetsuar. Menaxhmenti e përcakton klasifikimin e mjeteve financiare në njohjen fillestare. Deri në datën e bilancit të gjendjes FBK nuk ka asete të klasifikuara në kategoritë e vlerës fer përmes Fitimit apo Humbjes asetëve të gatshme për shitje.

2.5 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë mbahen në bilancin e gjendjes sipas koston. Për qëllime të pasqyrës se rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paranë në dorë dhe depozitat e mbajtura në bankë të pa afatizuara.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK**Shënimet e Pasqyrave Financiare**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021

*Të gjitha shumat në Euro***3. Pasurit qarkulluese**

Kosto	Pajisjet sportive	Gjithsej
Me 01 janar 2022	0	0
Blerjet gjatë vitit	36,094	36,094
Shpenzimi zhvlerësimit	(3,609)	(3,609)
Me 31 dhjetor 2022	32,485	32,485

4. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Me 31 dhjetor	2022	2021
TEB Bank	8,770	58,317
Paraja në arkë	179	156
Total	8,949	58,472

5. Llogaritë e Arkëtueshme

Me 31 dhjetor	2022	2021
Të hyrat nga klubet	152,565	117,302
Vitaminka	1,000	-
FIBA	-	6,319
Reload	5,000	5,000
Art Motion	-	-
FSHB	24,000	24,000
Total	182,565	152,621

Në llogaritë e arkëtueshme janë të përfshira borxhet nga klubet e basketbollit për të hyrat e paarkëtuara prej vitit 2019 deri 2022 me vendim të bordit të datës 30 korrik 2020 për shkak të situatës së krijuar me pandeminë Covid19, bordi ka marrë vendim që të gjitha obligimet e klubeve ndaj FBK-së t'i "ngrijë" deri në datën e regjistrimit të tyre për licencimin e garave 2021-2022.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK
Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021
 Të gjitha shumat në Euro

6. Llogaritë e Pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqesin borxhet që i ka Federata në fund te vitit 31 dhjetor 2022.

Me 31 dhjetor	2022	2021
Auto Mita shpk	3,727	
Baker Tilly	800	
Harod Associates Limited	3,800	
FAME Shpk		5,039
Hotel International Prishtina		35,000
Base Advertising Agency		1,416
Compact Color SH.P.K.		10,148
Data Project Electronics	50	3,960
Sporting	7,927	
Taunita NPH		13,000
Golden Taxi	8,966	3,571
Grand Hotel Prishtina	12,091	14,591
Marigona Tower SH.P.K.	40,614	14,035
Kena Komerc		4,250
My Travel SHPK		9,924
Norges Basketball Federation		6,807
Hotel Palace & SPA Center	4,406	
Ibrahim I. Berisha B.I.	2,430	
Lentil Foods shpk	5,784	
The Danish Basketball Association	8,439	
Shpenzimet akruale	50,481	40,544
Detyrimet tjera	31,235	12,222
Nën-totali	180,751	174,507
Starcard(Teb)	4,549	3,199
Total	185,300	177,706

7. Të pagueshmet tjera

Me 31 dhjetor	2022	2021
Tatimi ne qira	5,628	2,184
Tatimi ne paga	34,190	16,240
Kontributet pensionale	46,106	24,787
Pagat e pagushme	280	230
Total	86,204	43,441

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK**Shënimet e Pasqyrave Financiare**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021

*Të gjitha shumat në Euro***8. Të hyrat**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2022	2021
Të hyrat nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	389,840	338,375
Të hyrat nga FIBA	172,923	148,943
Nën-total (I)	562,763	487,318
<i>Të hyrat nga sponsorët</i>		
Të hyrat nga TEB	200,000	110,000
Të hyrat nga Vitaminka	12,000	12,000
Të hyrat nga Kujtesa	100,000	100,000
Të hyrat nga AutoMita	15,733	-
Të hyrat nga Shita & Associates	25,000	25,000
Të hyrat nga Ventius	100,000	50,000
Të hyrat nga Tregtia shpk	30,000	10,000
Të hyrat Black and Red	-	2,000
Të hyrat Bipharm	-	11,000
Të hyrat Alfa	-	3,000
Të hyrat IP-Kos	-	66,000
Të hyrat Art Motion	-	50,000
Të hyrat SHTBK	-	875
Të hyrat EBC	-	10,000
Nën-total (II)	482,733	449,875
<i>Të hyrat nga aktivitetet</i>		
Të hyrat nga aktivitetet	269,985	154,663
Komuna e Prishtinës	6,050	4,000
Të tjera	17,087	136,751
Nën-total (III)	293,122	295,414
Gjithsej Të hyrat (I+II+III)	1,338,618	1,232,607

9. Shpenzimet e Pagave

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2022	2021
Shpenzimet për pagat e stafit FBK	139,676	99,445
Kontributet	8,384	19,078
Gjithsej	148,060	105,064

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK
Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021
 Të gjitha shumat në Euro

10. Shpenzime operative

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2022	2021
Shpenzimet për paga të personave zyrtarë të ndeshjes	147,357	148,034
Shpenzimet për paga dhe meditje për trajnerë, komisione në FBK, aktivitete tjera(Liga Unike, Qendra Nacionale, Përfaqësueset e Kosovës, YDF, Junior NBA,Kurset dhe Klinikat për Gjyqtarë dhe Trajnerë, Kampionati Evropian, aktivitetet tjera)	229,412	172,186
Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit (Liga Unike, Qendra Nacionale, Përfaqësueset e Kosovës, YDF, Junior NBA,Kurset dhe Klinikat për Gjyqtarë dhe Trajnerë, Kampionati Evropian, aktivitetet tjera)	283,930	221,304
Regjistrimi I lojtarëve të huaj FIBA	36,828	49,602
Ushqim për lojtarët dhe stafin (Përfaqësueset,Qendra Nacionale Nacionale,Aktivitete tjera)	53,374	52,001
Shërbime mjekësore (Përfaqësueset, Kampionati Evropian, YDF, Qendra Nacionale,etj)	8,960	18,936
Medikamente	60	401
Shpërblimet(Edicioni 2021/22, Liga Unike)	85,525	-
Subvencione për klube	10,500	-
Shpenzime për pajisje zyrtare	18,297	40,062
Shpenzimet për trajnime dhe seminare	-	750
Participim	225	4,700
Fondi për të drejtat televizive	24,000	-
Shpenzimet për zyre	39,448	24,785
Shpenzimet e qirasë	35,087	21,138
Makina me qira	18,099	4,891
Konsulencë	12,099	5,667
Marketing	9,514	45,778

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK**Shënimet e Pasqyrave Financiare**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021

Të gjitha shumat në Euro

Shpenzimet e telekomunikimit	3,155	2,273
Shpenzime komunale	6,797	5,623
Mirëmbajtje dhe rregullime	1,096	103
Sigurime tjera gjatë kampionatit	9,077	4,080
Donacion	4,800	4,800
Shpenzimet e testeve për Covid	2,865	25,189
Përmbarimi	-	8,136
LED, Rekuizita, Brendime	85,402	77,183
Shpenzime të tjera	37,594	58,450
Shpenzimet e zhvlerësimit	3,609	-
Gjithsej Shpenzimet Operative	1,228,000	1,032,814

11. Ngjarjet pasuese

Në Dhjetor 2019, shpërtheu një lloji i ri i koronavirusit, COVID-19, dhe brenda disa javësh, megjithë përpjekjet për të mbajtur virusin e izoluar, ai u përhap dhe kjo pati një ndikim në mbylljen e qyteteve dhe bizneseve globalisht dhe numri i të infektuar u rritë ndjeshëm, përfshirë këtu edhe Kosovën. Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli situatë pandemie për shkak të emergjencës globale të shkaktuar nga shpërthimi i COVID19. Përhapja e koronavirusit ende po evolon dhe efektet e saj mbeten të panjohura.

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasuese pas datës së raportimit që kërkon ndonjë rregullim ose shpalosje në këto pasqyra financiare